



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. K1/I74-2 Prot.**  
**Nr. Dok. 202002695/2**

**Tiranë 10.09.2020**

**Lënda :** *Rekomandim për realizimin e procesit të ratifikimit të Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare.*

**Drejtuar :** **Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë**  
**Z. Gramoz RUÇI**

**Tiranë**

**Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë**  
**Z. Edi RAMA**

**Tiranë**

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

I nderuar z. Kryeministër,

Avokati i Popullit, në rolin e institucionit të pavaruar kushtetues, garantit të lirive të ligjshme dhe të drejtave të njeriut, si dhe të promovuesit të standardeve më të larta të shtetit të së drejtës, ka ndjekur me një vëmendje të posaçme një sërë iniciativash dhe zhvillimesh institucionale dhe ligjore, të cilat ndërthurin në vetvete promovimin dhe garantimin e këtyre standardeve në respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht në kuadër të të drejtave të minoriteteve kombëtare.

Në këtë këndvështrim të gjerë, të të drejtave dhe lirive të ligjshme të njeriut në vendin tonë, vëmendje i është kushtuar analizës së kujdesshme të situatës se, ku jemi sot sa i takon respektimit të të drejtave të minoriteteve kombëtare dhe se, çfarë masash po ndërmerren për sigurimin e ushtrimit efektiv të tyre.

Pas viteve 90', me vendosjen dhe zbatimin e sistemit të demokracisë liberale në vend, trajtimi i pakicave ka marrë një dimension të ri, fakt që duket qartë në angazhimet konkrete që vendi ynë ka ndërmarrë për këtë qëllim.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ka sanksionuar parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, pavarësisht përkatësisë së individit në pakicën përkatëse. Për më tepër, në nenin 20 të Kushtetutës, në mënyrë të shprehur parashikohet që personat të cilët u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore, si dhe kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato.

Kushtetuta iu ka njohur gjithashtu edhe të drejtën të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.

Anëtarësimi i Shqipërisë në një sërë organizatash dhe organizmash ndërkombëtarë me fushë veprimtarie mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe ratifikimi i një numri të konsiderueshëm aktesh ndërkombëtare, të qëllimura veçanërisht në afirmimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave,<sup>1</sup> flasin jo vetëm për një aspekt human të trajtimit të çështjes, por edhe për një angazhim serioz institucional të vendit tonë në këtë drejtim.

Zhvillimet pozitive kanë vijuar me miratimin dhe hyrjen në fuqi, të ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, apo edhe të miratimit dhe hyrjes në fuqi të disa prej akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, proces ky që, megjithëse ka evidentuar vonesë në kohë, po vazhdon me diskutimin dhe konsultimin e projektakteve të nevojshme nënligjore, që duhen paraqitur për miratim nga ana e institucioneve përgjegjëse shtetërore, në Këshillin e Ministrave.

Ky realitet zhvillohet në një mjedis ku mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pjesë e të cilave janë edhe të drejtat e pakicave/minoriteteve kombëtare janë formuluar si një kriter politik për Shqipërinë, e cila si një vend aspirues duhet ta përmbushë për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE).

Duke u fokusuar në këtë aspekt, konstatojmë se vendi ynë mund e duhet të bëjë progres të mëtejshëm, në afirmimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve kombëtare, kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore. Shqipëria, si vend anëtar i Këshillit të Evropës, megjithëse nuk ka nënshkruar ende Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare, ka treguar vullnetin e duhur për të ndërmarrë nisma të qarta dhe dobiprurëse në këtë drejtim.

Nënshkrimi i këtij akti të rëndësishëm ndërkombëtar, që mbron dhe promovon gjuhët rajonale dhe ato minoritare, pavarësisht problematikave ekzistuese, të identifikuara në raportet e progresit të Këshillit Evropian, në lidhje me këto të drejta të pakicave kombëtare në Shqipëri, është tashmë një hap i nevojshëm dhe i rëndësishëm për t'u kryer.

Shumë shtete evropiane kanë në territorin e tyre grupe autoktone të vendosura në bazë krahinash që flasin një gjuhë të ndryshme, nga gjuha e shumicës së popullsisë. Kjo ka ardhur si pasojë e proceseve historike, sipas të cilave formimi i shteteve nuk ka ndodhur mbi bazën e linjave të qarta të lidhura me gjuhën dhe ku, komunitetet e vogla janë “gllabëruar” nga komunitetet e mëdha.

Masat e marra në kontinentin evropian për ruajtjen e gjuhëve rajonale, ose minoritare, nga pashmangshmëria e ndikimit standardizues të civilizimit modern, veçanërisht të masmedias, si dhe nga një mjedis i mundshëm jo miqësor, asimilues, janë një qëllim shtetëror edhe i vendit tonë, prandaj duhet që të ndërmarren hapa të mëtejshëm, të nevojshëm, që qëllimojnë pikërisht këtë qasje të mbrojtjes sistematike, pozitive, ndaj gjuhëve rajonale, ose minoritare.

---

<sup>1</sup> Veçojmë këtu ratifikimin pa asnjë rezervë të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës, për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, në nenin 14, afirmon parimin e mosdiskriminimit, duke parashikuar në veçanti aspektin e gëzimit të të drejtave dhe lirive të garantuara nga kjo konventë, përmes garantimit të mbrojtjes nga çdo diskriminim të shkaktuar nga gjuha e përdorur e komunikimit, ose lidhja me një pakicë kombëtare. Megjithëse një akt ndërkombëtar shumë i rëndësishëm, kjo Konventë krijon vetëm një të drejtë për individët, për të mos qënë objekt diskriminimi, por nuk krijon një sistem mbrojtjeje pozitive për gjuhët e pakicave dhe komuniteteve, që i përdorin këto gjuhë.

Në këtë kontekst problematik dhe i paraprirë nga disa zhvillime institucionale rekomanduese/normuese (siç edhe Rezoluta nr.136, e Asamblesë Konsultative, në vitin 1957; Rekomandimi 285, i Asamblesë Parlamentare ku bëhet thirrje për hartimin e një mase mbrojtëse për të plotësuar Konventën Evropiane në mënyrë që të sigurohen të drejtat e pakicave për të gëzuar kulturën e tyre, për të hapur shkollat e tyre, etj; Rekomandimi 928, i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për problemet arsimore dhe kulturore dhe dialektet në Europë), hartimi i Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare, u konkretizua në Rezolutën nr.192 (1988), të Konferencës së Përhershme, ku u propozua teksti i kësaj Karte, të projektuar me statusin e një konvente ndërkombëtare.

Karta Evropiane e Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare, u miratua si Konventë nga Komiteti i Ministrave, të Këshillit të Evropës, në 25 Qershor 1992 dhe u hap për nënshkrim, më 5 Nëntor 1992, në Strasburg. Siç bëhet e qartë edhe në Preambul, qëllimi kryesor i Kartës është aspekti kulturor, i lidhur ngushtësisht me mbrojtjen dhe nxitjen e gjuhëve krahinore ose të minoriteteve, si një aspekt i kërcënuar i trashëgimisë kulturore, të Evropës.

Karta Evropiane e Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare, parashikon mbrojtjen dhe zhvillimin e gjuhëve krahinore ose të minoriteteve, por jo të vetë pakicave gjuhësore. Ajo nuk përcakton të drejta individuale, ose kolektive për folësit e gjuhëve krahinore, ose të pakicave. Gjithashtu, duhet theksuar se, kjo Kartë nuk trajton situatën e gjuhëve të reja dhe shpesh jo evropiane, të cilat mund të kenë dalë në shtetet nënshkruese si rezultat i rrjedhave migruese të kohëve të fundit, të cilat shpesh shkaktohen nga motive ekonomike.

Në frymën dhe përmbajtjen e Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare, theksohet se, diversiteti gjuhësor është një ndër elementët më të vyer të trashëgimisë kulturore evropiane. Identiteti kulturor i Evropës, nuk mund të ndërtohet mbi bazën e standardizimit gjuhësor. Me këtë vizion, mbrojtja dhe forcimi i gjuhëve tradicionale krahinore dhe të pakicave të saj, përfaqëson një kontribut në ndërtimin e Evropës, e cila, sipas idealeve të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, mund t'i ketë themelet vetëm në parimet pluraliste.

Duke u rikthyer tek gjendja aktuale në Shqipëri, në frymën e përçuar nga Karta Evropiane e Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare, evidentojmë se, ligji nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, (i cili ka karakter deklarativ), mbulon disa boshllëqe të vërejtura në situatën mbi përdorimin e gjuhëve të minoriteteve.

Kështu, ai u njeh individëve pjestarë të minoriteteve kombëtare, të drejtën e arsimit në gjuhën e minoritetit, garanton lirinë e shprehjes, të mendimit dhe të drejtën e informimit në gjuhën e minoritetit përkatës kombëtar, të drejtën e përdorimit të gjuhës së minoritetit të cilit ata i përkasin, në kuadër të njësisive të vetëqeverisjes vendore ku numri i individëve që i përkasin minoriteteve kombëtare, përbën 20 përqind të popullsisë së përgjithshme, të tyre.

Pra, ligji e lidh ushtrimin e të drejtave gjuhësore me legjisllacionin përkatës ekzistues, ose me vendimet përkatëse administrative, duke e lënë zbatimin e tij në vullnetin e mirë të autoriteteve të vetëqeverisjes vendore. E megjithatë, ushtrimi efektiv i së drejtës së minoriteteve kombëtare të njohura zyrtarisht në vendin tonë, për të përdorur ose marrë informacion në gjuhët e tyre

minoritare, ka evidentuar problematika të tjera që flasin për nevojën e plotësimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit të brendshëm për këtë qëllim.

Krijimi i një marrëdhënie të besueshme me pakicat kombëtare në vend, bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare në këtë gjendje ekzistuese, ku shpesh shfaqet edhe mosbesim nga ana e pakicave, do të mund të realizohej përmes veprimeve konkrete nga ana e institucioneve përgjegjëse shtetërore, për realizimin e procesit të ratifikimit nga ana e Shqipërisë, të Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare.

Respektimi i të drejtave gjuhësore të minoriteteve kombëtare është thelbësor për avancimin e të drejtave të këtyre minoriteteve, por edhe të të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Në këtë kuptim, Karta Evropiane e Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare, identifikon një mjet efektiv, për ruajtjen e të gjitha gjuhëve minoritare dhe për mbrojtjen e ekzistencës së tyre në një plan afatgjatë.

Në kujtesën institucionale të aktorëve përgjegjës shtetërorë që mbulojnë këtë fushë, duhet sjellë në vëmendje fakti se nuk kanë munguar aktivitetet që qëllimjnë njohjen e përmbajtjes dhe të detyrimeve, që rrjedhin nga nënshkrimi i Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare,<sup>2</sup> fakt që flet për një qasje të hershme ndaj kësaj çështjeje, por ende të pakonkretizuar me ratifikimin përkatës nga ana e Shqipërisë.

Ky është një proces, i cili është rekomanduar hershëm edhe nga ana e Avokatit të Popullit, në rekomandimet që ai ka paraqitur në kuadër të Raportit të Veçantë “Për gjendjen e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri”, dërguar Kuvendit të Shqipërisë, në muajt e parë të vitit 2015. Në këtë raport të veçantë është theksuar nga ana jonë se, nevojitet ndryshimi dhe përmirësimi i legjislacionit të brendshëm në këtë fushë, kjo e vlerësuar ndër të tjera ngushtësisht edhe me ratifikimin nga ana e Shqipërisë, të Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare.

Kërkesa thelbësore për forcimin e sistemit mbrojtës të minoriteteve kombëtare në Shqipëri, ka qënë gjithmonë dhe mbetet një nga prioritetet kryesore në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të ligjshme të njeriut, në tërësinë e tyre.

Rëndësi specifike në këtë moment për vendin tonë, ka përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor në këtë fushë dhe harmonizimi i tij, me “Acquis” të BE-së, duke miratuar standarde specifike për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare, standarde këto të formuluar në politikën e zgjerimit të BE-së, në procesin e stabilizim-asociimit, si dhe në instrumentet që i shoqërojnë këto procese.

Mbi këtë bazë aktuale vlerësojmë se ka ardhur momenti që, të gjithë aktorët institucionalë përgjegjës shtetërorë, të konsiderojnë seriozisht dhe të realizojnë procesin e rëndësishëm të ratifikimit, të Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare.

Në vizion e Avokatit të Popullit, mbrojtja e ekzistencës së minoriteteve kombëtare dhe akomodimi i diversitetit në shoqëri duhet të jetë një objektiv i përhershëm i shtetit shqiptar, me qëllim që të ndërmarren masat e nevojshme për zgjidhjen e problemeve që vërehen në këtë fushë.

Respekti ndaj të drejtave të minoriteteve nuk është një privilegj që shteti dhe shoqëria jonë iu bënë atyre, por një detyrim dhe një proces i natyrshëm që bazohet tek dinjiteti njerëzor dhe diversiteti, duke prezantuar kështu një “investim” madhor, që një shoqëri i rezervon vetvetes për të ardhmen.

Për sa më sipër,

---

<sup>2</sup> Zyra e Këshillit të Europës në Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Komitetin Shtetëror për Minoritetet, organizuan në 7-8 dhjetor 2007, një seminar informues për mekanizmat e Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare, si dhe detyrimet që lindin nga nënshkrimi i kësaj Karte.

## **REKOMANDOJMË**

Realizimin në një kohë të shpejtë, të mundshme, të procesit të ratifikimit të Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale, ose Minoritare, nëpërmjet angazhimit institucional të të gjithë institucioneve përgjegjëse shtetërore, në këtë proces të rëndësishëm për sistemin tonë të brendshëm juridik, në kuadër të garantimit, mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të ligjshme, të minoriteteve kombëtare, në Shqipëri.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin Tuaj,

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**